



## **Protokoli i Mbledhjes Diskutim Publik mbi Draft Rregulloren për Vënien e Çmimeve**

**Data: E hënë, 26 shtator 2005 , prej orës 10.00 -12.30**

**Vendi: Zyrat e ZRRE-së**

**Pjesëmarrës: 34 vetë**

Ju lutem referojuni prospektit: Draft Rregullorja mbi Përlllogaritjen e Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike(15 faqe, 30 sllajde).

**Mirëseardhja dhe Prezantimi** prej Nick Frydas: deri tani i kemi marrë komentet dhe do të diskutojmë mbi të gjithë temat. Aktivitetet e rregulluara energjetike janë Rregullorja mbi Vënien e Çmimeve dhe fazat e tjera të veçanta do të jenë: Shqyrtimi i Çmimeve (maksimumi i të ardhurave vjetore të lejuara që do të përcaktohen nga ZRRE-ja); tarifat e detajuara, të cilat duhet të përputhen me të ardhurat vjetore të lejuara, do të dorëzohen prej ndërmarrjes energjetike.

Këto janë tre dokumentet që do të nxirren dhe miratohen prej ZRRE-së:

Rregullorja mbi vënien e çmimeve: që do të diskutohet dot dhe që përshkruan procesin dhe kornizën.

Metodologjia e Tarifave: Kjo do të diskutohet në Tetor dhe do të përcaktohet për çdo aktivitet.

Udhëzimet për Kontabilitetin Rregullator: formati i të dhënave rregullohet nga ZRRE-ja dhe lëshohet në tetor.

**Merita Kostari** shpjegoi se Ligji mbi Rregullatorin e Energjisë përmend detyrimin për të nxjerrë rregullën dytësore. Bordi i Drejtorëve tashmë është krijuar dhe kjo draft Rregullore mbi Vënien e çmimeve është një prej legjislacionit dytësor. Është botuar më 18 gusht 2005 në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, dhe tashme kemi marrë komentet prej pjesëmarrësve. Shpresojmë të marrim më shumë komente gjatë prezantimit dhe gjatë pushimit të kafes. Gjatë 3-4 muajve të ardhshëm, do të kemi më shumë sesione publike si këto, dhe shpresojmë që të përmirësojmë sektorin energjetik. Kjo Rregullore mbi Vënien e Çmimeve tashmë ka kaluar përmes Departamentit Ligjor.

**Theranda Beqiri** bëri prezantimin për Draft Rregulloren mbi Përlllogaritjen e Tarifave në Sektorin e Energjisë Elektrike në anglisht. Adelina Murtezaj dhe Alketa Sala përkthyen në shqip.

Nick Frydas përmendi gjatë prezantimit se audienca mund të ndërhyjë në çdo kohë gjatë prezantimit, në rast se diçka nuk është e qartë.

### **Pyetje: Sa do të zgjasë procesi i konsultimit?**

Përgjigje e NF<sub>1</sub>: Procesi i konsultimit do të zgjasë deri sot.

NF i kërkoi WD<sub>2</sub> të bëjë prezantimin e tij në lidhje me ‘Normat e bazuara në Performancë’ dhe ‘shpenzimet e justifikuara’.

WD: Normat e bazuara në performancë përmenden në Ligjin mbi Rregullatorin e Energjisë dhe nënkuptojnë përfshirjen e një faktori të efikasitetit, ose lidhet me standardet e performancës. Mënyra se si e interpretojmë këtë në Metodologjinë e Tarifave është e njëjtë me përdorimin e



çmimit tavan ose masa të tjera të ngjashme. Kur vendosen tarifat, priten përfitime efikase. Kjo do të prezantohet më vonë në Metodologjinë e Tarifave.

Shpenzimet e justifikuara: të gjitha shpenzimet nuk do të përçohen tek konsumatorët. Shpenzimet e lejuara të përfshira në tarifa, duhet të jenë efikase dhe ZRRE-ja ka nevojë të sigurojë dëshmi që ato janë efikase. Këto kosto do të krahasohen me vende të tjera si Bullgaria, Maqedonia dhe Shqipëria. Nëse shpenzimet në Kosovë janë të ndryshme, kompania duhet të japë një justifikim se pse ato janë ndryshe në krahasim me vendet fqinjë.

-----  
1 NF: Nick Frydas

2 WD: William Derbyshire

Shpenzimet e Mbetura janë ato kosto që nuk mbulohen në një treg konkurrues, të aprovuar më herët nga Rregullatori. P.sh. Rregullatori aprovoi Marrëveshjen e Blerjes, cili çmim është më i lartë se çmimi konkurrues, kur përfshihet tregu konkurrues. Kjo do të thotë se çmimi në Marrëveshjen e Blerjes është shumë i lartë dhe ndryshimi midis çmimit të tregut dhe çmimit të kontratës është i mbetur (kostoja e mbetur). Në Kosovë do të ketë konsulentë të veçantë që do të vlerësojnë këto kosto të mbetura përpara dhjetorit. Kjo do t'i referohet vetëm aseteve dhe investimeve përpara 30 qershorit 2004 kur është shpallur ligji mbi Rregullatorin e Energjisë, dhe kur këto kosto nuk mund të rifitohen në tregun konkurrues.

Pyetje: Mbi Rregulloren e Tarifave: a mund të jepni më shumë shpjegim në lidhje me kohezionin ekonomik dhe social?

WD: Ju nuk vini çmime të ndryshme brenda Kosovës. Çmimi në Mitrovicë do të jetë i njëjtë me atë në Prishtinë. Rregullorja mbi Vënien e Çmimeve përmend parimet që duhet të marrim në konsideratë. Tarifa duhet të pasqyrojë çmimin: kostoja në Mitrovicë është më i lartë se në Prishtinë dhe ju duhet t'i ngarkoni konsumatorët më shumë. Sidoqoftë Rregullatori duhet të konsiderojë se cili është balancimi i duhur midis kohezionit të pasqyrimin të çmimit dhe atij social.

NF: për të njëjtën klasë konsumatorësh do të vihen tarifa të njëjta në të gjithë Kosovën. Për konsumatorët shtëpiakë: të njëjtat tarifa të përshkallëzuara nga tarifa e linjës së jetës.

#### **Pyetje: a nuk do të rregullohet tarifa sipas ndryshimeve demografike?**

NF: njerëzit në fshat do të kenë të njëjtat tarifa si në Prishtinë, edhe pse kostoja në Prishtinë është më e ulët. Kjo kosto e tepërt do të socializohet. Qeveria mund të ngarkojë taksa shtesë, por kjo është jashtë energjisë elektrike. Përveç çështjes së varfërisë, nuk do të ketë zbritje të tjera nga tarifat në këto zona gjeografike.

#### **Pyetje: A mund të përfshihet Qeveria në këtë proces subvencionimesh?**

WD: Qeveria nuk mund t'i japë udhëzim ZRRE-së për të subvencionuar ose ngarkuar tarifat që nuk pasqyrojnë koston për një grup të caktuar konsumatorësh. ZRRE i bazon tarifat mbi shpenzimet e justifikuara. Nëse Qeveria do të sigurojë para ndarazi për grupet e konsumatorëve individualë për të ndihmuar pagimin e faturave të energjisë elektrike, kjo i takon Qeverisë.

NF: ZRRE-ja nuk ka çfarë të thotë për subvencionet ose taksat e Qeverisë.

Pyetje: Tarifat: praktika në vende të tjera është se tarifa bazohet në GDP (prodhimi i përgjithshëm vendor-PPV); ne në Kosovë kemi tarifën më të lartë në krahasim me vendet fqinjë. Pse të mos aplikojmë të njëjtën gjë? Në lidhje me subvencionet, Ministria e Mirëqenies Sociale do të merret me këtë gjë.



NF: Nuk është e vërtetë se në vende të tjera tarifa bazohet mbi GDP-PPV. Kjo do të thotë se Gjermania që ka një PPV më të lartë, duhet të ketë tarifë më të lartë, e njëjta gjë dhe për SHBA-të; ky nuk është rasti!. Në Evropën juglindore ne do të kemi tarifa që reflektojnë koston pa ndër-subvencione(subvencione të kryqëzuara). Edhe pse ne kemi tarifa të larta në Kosovë, ende nuk i kemi rishikuar. Procesi do të fillojë me Bankën Botërore dhe bazohet në Metodologjinë e tarifave: pas kësaj ne do të shohim se ku jemi. Mund të ndodhë se kemi tarifë të lartë: kjo duhet të pasqyrojë koston e prodhimit të Energjisë elektrike.

Ministria e Mirëqenies Sociale: KEK-u për familjet e varfra duhet të thithë këtë sasi prej buxhetit në përputhje me metodologjinë e tarifave. Ne mendojmë se gjatë hartimit të tarifës së linjës së jetës, konsumatori në të njëjtën kategori do të subvencionojë për njerëzit e varfër, përshkallëzuar me nivelin e kërkesës.

Pyetje: si duhet të merremi me situatën ku Furnizuesi Publik nuk merr kapacitet të mjaftueshëm prej Prodhuesit Publik? Furnizuesi Publik nuk mund të blejë mjaft energji elektrike nga Prodhuesi Publik, prandaj për mua nuk ka nevojë për konsumatorë të kualifikuar(eligible costumers-konsumatorë të kualifikuar, pra që kanë të drejtë të zgjedhin shërbimet)

NF: energjia elektrike e importuar nuk është një tarifë e rregulluar, por ZRRE-ja do të aprovojë shpenzimet e justifikuara.

Sean McGoldrick prej KEK: i referohem programit ditor të ndërprerjes së rrymës, me anë të të cilit rrjeti i shërbimeve publike do të krijojë kosto të rritura. Cilat janë komentet tuaja?

NF: në lidhje me shpenzimet shtesë të shpërndarjes dhe transmetimit që kanë të bëjnë me shkurtimin e ngarkesës, ato do të trajtohen si kosto të justifikuara.

**Sqarim:** periudha për kontrollimin e çmimit do të jetë 3 vjeçare. Sapo të krijohen të ardhurat vjetore të lejuara, tarifa do të bëhet fikse dhe rifillimi do të aplikohet vetëm kur të ketë një faktor përshkallëzues.

Për Shpërndarjen dhe Transmetimin: 3 vjet. Sipas ligjit, shpenzimet e gjenerimit do të shqyrtohen çdo vit. Tashmë kjo është e rregulluar me ligj.

Pyetje: në rregulloren e përkohëshme cilët do të jenë llojet e standardeve të cilësisë,për shkak të çështjeve teknike?

NF: cilësia varet mbi Investimet dhe ka një pasqyrim mbi koston. Standardet e cilësisë do të përcaktohen nga ZRRE-ja dhe në rast të transmetimit, nga kriteret e UCTE-së. Gjatë përcaktimit të kostove të lejuara, ZRRE do të marrë parasysh nivelin e investimeve që nevojiten për të arritur cilësinë. Kur të arrihet ky nivel, ne mund të monitorojmë dhe aplikojmë dënimet përmes të licencuarve, p.sh. OSSH.

Komente shtesë prej Adrian Twomey: Monitorimi i cilësisë varet nga të dhënat e rregullta të të licencuarve tek ZRRE-ja. Cilësia rregullatore e shërbimit dhe furnizimit bazohet në besueshmërinë, cilësinë e voltazhit dhe informacionit mbi shërbimin e konsumatorit. Problem tek dënimet: nëse aplikohen, por për momentin ende nuk ka vendim përfundimtar.

Naim Bejtullahu: Standardet e furnizimit do të nxirren në kod teknik për Transmetimin dhe Shpërndarjen.

Pyetje nga KEK-u prej Sean McGoldrick (Shon Mekgoldrik)

Së pari, KEK përgëzon ZRRE-në për këtë Draft Rregullore mbi Vënien e Çmimeve: parimet janë të qarta dhe është një kornizë e mirë. KEK-u mbështet këtë draft rregullore. Shon ka 8 pyetje specifike:



P1: Neni 7.1: Ndërmarrjet Energjetike çdo vit do të dorëzojnë tarifën e propozuar tek Zyra e Rregullatorit të Energjisë.

Kjo imponon një ngarkesë rregullatore mbi industrinë, pasi KEK-u nuk ka pasur tarifën e reja që prej 5 vjetësh.!

NF: Industria për 5 vjet nuk ka dorëzuar tarifën e reja dhe tashmë ka ardhur koha që ne ta bëjmë këtë. Kemi dëgjuar komentet se kemi tarifën më të lartë në Rajonin e Evropës juglindore. Unë pres që rishikimi fillestar i çmimit, me anë të ndihmës së konsulentëve të financuar nga donatorët, do të kompletohet në një mënyrë të butë, dhe se ngarkesat vjetore do të jenë më të pakta.

WD: ekziston një kufizim ligjor: Ligji mbi Energjinë elektrike kërkon që çmimet në MBE-në e nënshkruar prej furnizuesit publik, dhe çmimet për qasjen në rrjet të aprovohen dhe rishikohen çdo vit nga ZRRE-ja. Pas rishikimit fillestar të çmimit, ne presim që ky do të bëhet një proces i gjerë automatik.

P2: Neni 8.1 dhe 8.3: të përcaktohet periudha e njoftimit. Nuk është specifikuar kushti për “kohë të përshtatshme”. Një synim specifik: numri i ditëve ose përcaktimi i “kohës së përshtatshme” do të ndihmojë.

WD: kjo çështje është ngritur edhe nga ZRRE-ja. Do të vendosim një afat kohor.

P3: Neni 16: Kushti për tarifën sociale: shumë mirë. Sidoqoftë në kushtet aktuale financiare, dhe mospagimit të dokumentuar mirë, zor që ka probabilitet për sigurimin e tarifave sociale përmes ndër-subvencionimi. Shqetësimi ynë është rreth ndikimit të mos-paguesve dhe mospagimit tek tarifën sociale.

N.F.: në ligj shkruhet: të gjithë mundësitë. Përmendet: ”mund të kërkohet”. Ka dy mundësi: (1) subvencionet në të njëjtën klasë konsumatorësh: stimulim menaxhimi ndaj kërkesës së konsumatorëve të lartë (2) subvencione të drejtpërdrejta prej qeverisë, që nuk është në preferencën tonë. Por ndikimi mbi mospagimin dhe konsumatorët e mirë, mund të vlerësohet vetëm nëse kemi përcaktuar tarifën.

W.D.: KEK-u duhet të kompensohet për këto humbje, për aq kohë sa ato janë të arsyeshme.

P4: Kapitulli 5: Tarifën e Transmetimit: si të mbulojnë shpenzimet e shërbimeve ndihmëse?

WD: Rregullorja që i përket kësaj përmendet në rregulloret e tregut, dhe jo në metodologjinë e tarifave. Këto kosto duhet të mbulohen.

P5: Neni 22.3 dhe 22.4: të dy implikojnë ndryshime në Sistemin e Faturimit. Kjo do të rezultojë në kosto të mëdha, çështje prokurimi dhe vonesa të lidhura me këto: ne do të kërkojmë që ZRRE-ja të japë kohë të mjaftueshme për të zbatuar këto ndryshime.

NF: sigurisht, sistemi i faturimit në industrinë e rishtrukturuara, ndryshon: ka disa variacione. Në Slloveni: të gjithë llogaritë e zbërthyer që konsumatori i paguan si përbërës për Zyrën e Rregullatorit, edhe pse shumë të vogla, duhet që të përmenden. Ne do ta marrim parasysh këtë, por KEK-u duhet të ndryshojë Sistemin e Faturimit në përputhje me llogaritë e veta të zbërthyer.

WD: ne e dimë se kjo do të marrë kohë për të futur sistemin e reja faturimi dhe ne do ta përfshijmë këtë në Kushtet Kalimtare, kompetencat e ZRRE-së për të vonuar kriteret për të identifikuar veçmas këto ngarkesa në faturat e konsumatorëve.

Naim Bejtullahu: ndihma teknike prej Bankës Botërore fillon në Nëntor dhe do të zgjasë për 8 muaj, kështu që ka mjaft kohë në dispozicion për të rregulluar Sistemin Faturues të KEK-ut.

P6: Neni 25.4 b): ZRRE-ja do të nxjerrë vendimin e vet brenda 45 ditëve. Jam kureshtar të di nëse do të ketë një diskutim publik.



WB: qëllimi është që ky të jetë vendimi. Çdo diskutimet publik do të mbahet përpara kësaj date dhe si rrjedhojë brenda një periudhe 45 ditore. Ne presim që diskutimet publike të mbahen vetëm, nëse ndodhin ndryshim domethënëse tek tarifat ekzistuese.

**P7: Neni 28: rishikimet e ekspertëve: pranimi nga të gjitha palët: përgjigje të drejtë dhe të arsyeshme nëse ZRRE-ja nuk gjen ndonjë gjë të papërshtatshme. Ne ndiejmë se çdo çështje ligjore vijuese do të zgjidhet përmes analizave dhe kjo do të shkurtojë procesin.**

P8: Heqja e ndër-subvencioneve: KEK-u mbështet dhe bie dakord me këtë parim. KEK-u preferon të informojë se ka ndër-subvencione në tarifat ekzistuese dhe heqja e këtyre do të krijojë një 'shok të normës' dhe shumë konsumatorë do të shohin një ndryshim në normat e tyre. KEK-u do t'i kërkojë ZRRE-së nëse ka mekanizma që e lehtësojnë këtë shok.?

NF: ka një kufizim të direktivave të BE-së që ndalon ndër-subvencionimin e konsumatorëve të ndryshëm. Ka një rrugëzgjdhje: rishikimi i çmimit: ju nuk do të mbështetni 2 vitet e para.

Unë hezitoh të propozoj ndonjë mekanizëm tjetër përpara se të fillojë rishikimi i tarifave në nëntor 2005. Sa është madhësia e shokut? Në këtë moment, më shumë se 70% e konsumatorëve janë shtëpiakë.

WD: Në fakt, i takon KEK-ut të menaxhojë këtë shok të normës, pasi tarifat aktuale i ka propozuar KEK-u.

Sean Mc Goldrick: nëse tarifat e përgjithshme do të mblidheshin plotësisht, do të mbulonin shpenzimet e një norme të favorshme kthimi. Në fakt, ka elementë të ndryshëm të ndër-subvencioneve midis konsumatorëve dhe bizneseve të ndryshëm. Rezultati i mospagimit: 76% janë shtëpiakë dhe 8% industrialë. Pagimi dhe humbjet komerciale ndryshojnë midis kategorive të ndryshme.

**Pyetje: pas Shqyrtimit të çmimit, cili do të jetë çmimi?: a do të bazohet mbi shpenzimet marxhinale (kufitare) apo mbi shpenzimet mesatare?**

WD: çmimi do të bazohet mbi shpenzimet mesatare të lejuara: ky nivel do të ndryshojë me kalimin e kohës duke parë përmirësimet e pritura të efikasitetit. Nëse ndërmarritet shesin poshtë kostos mesatare, do të jetë e pranueshme për konsumatorët, por nuk do të jetë e zbatueshme për kompaninë.

Përgjigje: Qeveria duhet të ulë taksat.

WD: Nëse kompania nxjerr fitim, atëherë ky fitim mund të ndihmojë, por në rast se kompania del me humbje, atëherë kjo nuk do ndihmojë fare, dhe do të përbëjë problem. Sidoqoftë, në energji elektrike, kostoja marxhinale është shumë e ulët: kostoja e furnizimit të një njësie shtesë është shumë e vogël, dhe për këtë arsye, aq më shumë nevojiten uljet e taksave.

**William Derbyshire prezantoi pyetjet dhe përgjigjet e marra prej mbështetësve dhe të tjerëve.**

Përfundimi i takimit prej Nick Frydas:

- Draft Rregullorja për vënien e çmimeve, përfshirë gjithë komentet e marra, do të botohen nesër në mbrëmje në faqen zyrtare të ZRRE-së.
- Do të keni afat edhe 2 javë për më shumë komente, dhe në rast se nuk ka komente madhore, ZRRE-ja do të miratojë Rregulloren mbi vënien e çmimeve.
- Ky është dëgjimi ynë i parë publik: është një proces dhe një lakore e të mësuarit për ZRRE-në dhe për mbështetësit.
- Ky është stadi përfundimtar përpara miratimit të kësaj Rregulloreje.



William Derbyshire prezantoi Draft Metodologjinë për Tarifat.

Ky draft është bërë nga konsulentët dhe ende do të rishikohet nga ZRRE dhe do të botohet në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së në javët e ardhshme. Do të mbahet një workshop publik me prezantim. Përpara kësaj, konsulentët përgatisin një prospekt në anglisht (shpërndarë për pjesëmarrësit) për të prezantuar metodologjinë e propozuar dhe të lejuar kohë shtesë për rishqyrtim nga mbështetësit. Do t'u japë njerëzve mundësinë që të shohin metodologjinë e tarifave. Draft metodologjia e botuar për komente në faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së, do të jetë në tre gjuhë: anglisht, shqip dhe serbisht.

**Vërejtje prej një pjesëmarrësi:** disa terma specifike janë përkthyer keq.: 'Eligible customers' në shqip janë përkthyer si "konsumatorë të përshtatshëm". Termat e rinj duhet të përkthehen si duhet.

**Fjalët e fundit prej Nick Frydas:** nuk ka më komente? Dëgjimi Publik për Rregulloren mbi Vënien e Çmimeve konsiderohet e mbyllur. Merrni prospektin prej William Derbyshire në lidhje me Metodologjinë e Tarifave dhe shihni faqen zyrtare elektronike të ZRRE-së për tekstin përfundimtar të Rregullores mbi Vënien e Çmimeve dhe draft tekstin mbi Metodologjinë e Tarifave.